

Keni nevojë të Regjistroheni në një Shkollë?

Kemi një vend për ju.



Programet e Fëmijërisë së Hershme

PROGRAME EDUKIMI PARASHKOLLOR 3-K DHE PRE-K

PËRSHTATSHMËRIA

- ☐ Fëmijët mund të regjistrohen në 3-K në vitin kalendarik kur mbushin moshën tre vjeçare.
- ☐ Fëmijët mund të regjistrohen në pre-K në vitin kalendarik kur mbushin moshën katër vjeçare.
- ☐ Disa programe të 3-K dhe Pre-K ofrojnë kujdes gjatë gjithë vitit dhe edukim për deri në 10 orë në ditë për ata fëmijë, të cilët kualifikohen bazuar në të ardhurat dhe nevojat e familjes.

SI TË REGJISTROHENI

- Familjet mund të eksplorojnë opsione në internet duke vizituar **MySchools.nyc** për të aksesuar direktoritë për 3-K dhe Pre-K.
- Brenda secilës direktori përdorni filtrin me titull "Keni nevojë për një vend për këtë vit shkollor?" ("Need a seat for this school year?") për të parë se cilat shkolla kanë vende të lira.
- Sigurohuni të vendosni adresën tuaj me qëllim që të gjeni shkolla më pranë shtëpisë suaj.
- Ju mund të kontaktoni drejtpërdrejt shkollat për të konfirmuar disponueshmërinë dhe për t'u regjistruar.
- Mësoni më shumë në **schools.nyc.gov/3K** ose **schools.nyc.gov/PreK**.



Nga Shkolla Fillore (Elementary School) deri në Shkollën e Mesme (Middle School)

KLASAT K-8

PËRSHTATSHMËRIA

- ☐ Fëmijët mund të regjistrohen në kopsht në vitin kalendarik kur mbushin moshën pesë vjeçare.
- ☐ Fëmijët mund të regjistrohen në klasën e parë në vitin kalendarik kur mbushin moshën gjashtë vjeçare.
- ☐ Nxënës/e që kanë nevojë të regjistrohen në klasat nga 2 deri në 8.

SI TË REGJISTROHENI

- Zbuloni nëse keni një shkollë në zonën e banimit duke vizituar **schoolsearch.schools.nyc** dhe duke vendosur adresën tuaj ose duke telefonuar në **311**.
- A keni një shkollë në zonën e banimit? Regjistrohuni direkt në atë shkollë; gjeni si dhe kur duke i kontaktuar apo vizituar ato.
- Nuk keni një shkollë në zonën e banimit? Kontaktoni direkt shkollat ose vizitoni një Qendër të Mirëseardhjes Familjare (Family Welcome Center - FWC). Për të mësuar më shumë, vizitoni **schools.nyc.gov/FWC**.



Shkolla e Mesme e Lartë (High School)

KLASAT 9– 12

PËRSHTATSHMËRIA

- ☐ Nxënës/e që kanë nevojë të regjistrohen në klasat nga 9 deri në 12.
- ☐ Nxënësi/e të moshës 15 vjeçare, pa të dhëna aktuale të arsimimit, mund të regjistrohen në shkollën e mesme të lartë (gjimnaz).

SI TË REGJISTROHENI

- Kontaktoni një Qendër të Mirëseardhjes Familjare për t'u regjistruar. Për të mësuar më shumë, vizitoni schools.nyc.gov/FWC.
- Përgatisni dokumentet e mëposhtëm:
 - Dëshmi e moshës së fëmijës (certifikatë lindjeje, pasaportë ose certifikatë pagëzimi)
 - Të dhënat e vaksinimit të fëmijës (nëse disponohen)
 - Dëftesat akademike/transkriptet më të fundit të fëmijës suaj (nëse disponohet)
 - Dy dokumente që vërtetojnë adresën tuaj të banimit - gjeni shembuj të dokumenteve të pranueshme në on.nyc.gov/RegistrationChecklist

Familjet që jetojnë në banesa të përkohshme nuk janë të detyruara të sjellin dokumentacion për regjistrim. Për të mësuar nëse kjo vlen për ju, vizitoni schools.nyc.gov/STH.

Kërkoni Mundësi për Fëmijë të Moshës nga 6 Javë në 2 Vjet?

Programet për foshnja dhe fëmijë të vegjël ofrohen gjatë gjithë vitit për fëmijët nga 6 javë deri në 2 vjeç, deri në 10 orë në ditë. Përshtatshmëria për t'u përfshirë bazohet në të ardhurat dhe nevojat familjare. Mësoni më shumë në on.nyc.gov/BrightStarts.

Po Aplikoni për Vitin e Ardhshëm Shkollor?

Nëse po kërkoni një shkollë për vitin e ardhshëm, mund të dorëzoni një aplikim gjatë periudhës së aplikimit për nivelet si më poshtë: 3-K, Pre-K, kopsht, klasa e gjashtë dhe e nëntë. Në atë kohë, mund të vizitoni MySchools.nyc për të hyrë në direktorinë në internet dhe në portalin e aplikimit.

Gjeni informacionin më të përditësuar mbi afatet e aplikimit dhe mënyrat e aplikimit në schools.nyc.gov/Admissions.

